

NOTË INFORMATIVE

Mbi kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedim disiplinor me masën “Vërejtje konfidenciale”, për magjistraten A.P.,

Hetimi disiplinor ndaj prokurores A.P., lidhet me konstatimin gjatë shtatorit të vitit 2019, të disa fakteve, që lidhen me shkelje të rregullave të sjelljes me personelin e administratës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat, me drejtuesin e prokurorisë dhe magjistratët e tjerë, të cilët kanë informuar Këshillin e Lartë të Prokurorisë për shkelje që lidhen me sjellje jo etike dhe joprofesionale gjatë ushtrimit të funksionit nga prokurorja.

Nga hetimi disiplinor i kryer nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë rezulton se:

- Magjistratja ka shkelur rregullat e sjelljes me personelin e administratës së prokurorisë, me drejtuesin e prokurorisë dhe me kolegët, në shkelje të parimit të respektimit të rregullave të etikës dhe sjelljes profesionale.
- Megjithëse veprimet e saj janë kryer me dashje, nuk rezulton të ketë ardhur ndonjë pasojë.
- Shkelja është kryer për herë të parë dhe sjellja joetike e prokurores ka qenë vetëm në fillim, për ato raste të referuara, edhe si pasojë e përvojës së pakët, pasi ishte e sapo emeruar (në korrik 2029) në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.
- Sjellja e e magjistrates subjekt hetimi disiplinor nuk mund të krijojë terren për sjellje të papërshtatshme edhe në rastet të tjera të ngjashme, kjo pasi edhe nga deklaratimet e marra rezulton se marrëdhëniet me të janë normalizuar dhe kjo magjistrate nuk ka shfaqur sjellje të tilla.
- Këto shkelje të konstatuara nuk lidhen me veprimtarinë e saj profesionale dhe mund të jenë të rëndësishme vetëm me qëllim vlerësimin etik dhe profesional të saj, por janë të natyrës që magjistratja duhet të mbajë përgjegjësi disiplinore. Përveç mbrojtjes së interesit publik, masa disiplinore përmbush edhe dy qëllime parandaluese: *parandalimin e posaçëm*, në kuptimin që magjistrati në të ardhmen të mos kryejë më shkelje disiplinore; dhe *parandalimin e përgjithshëm*, në kuptimin që magjistratët e tjerë kuptojnë, që një sjellje e papërshtatshme nuk duhet kryer, pasi është e ndëshkueshme me masë disiplinore.

Nga hetimi disiplinor konkludohet se sjellja dhe veprimet e magjistrates A.P. përbëjnë “*Shkelje të lehtë disiplinore*”, sipas parashikimeve të nenit 102, pika 2, shkronja “dh”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe i propozohet Këshillit të Lartë të Prokurorisë caktimi i masës disiplinore “*Vërejtje konfidenciale*”, për prokuroren A.P., të parashikuar nga neni 106 i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.